

VENDIM
Nr. 407, datë 5.7.2023

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE E TË RREGULLAVE PËR
PËRZGJEDHJEN, KONTRAKTIMIN DHE SHPËRBLIMIN E PËRKTHYESVE
ZYRTARË, SI DHE TË MËNYRËS SË KONTROLLIT TË SHËRBIMIT TË KRYER
NGA PËRKTHYESIT ZYRTARË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 12, të ligjit nr. 82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky vendim ka për objekt përcaktimin e kriterëve e të rregullave për përzgjedhjen, kontraktimin dhe shpërblimin e përkthyesve zyrtarë, si dhe të mënyrës së kontrollit të shërbimit të kryer nga përkthyesit zyrtarë, që janë certifikuar dhe regjistruar në regjistrin elektronik të përkthyesve zyrtarë, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara në ligjin nr. 82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar” (më poshtë “ligji për përkthimin zyrtar”).

Neni 2
Përkufizime

Për qëllime të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. **“Organ kontraktues”**, organet proceduese, Gjykata Kushtetuese dhe autoritetet e tjera publike, të cilave ligji u ka njohur të drejtën për përkthimin zyrtar, sipas ligjit për përkthimin zyrtar.
2. **“Versioni shqip i *acquis* të Bashkimit Evropian”**, versioni i përkthyer i aktit normativ përkatës të Bashkimit Evropian në gjuhën shqipe, i cili është gjuhësisht dhe juridikisht i barabartë me gjuhën burimore, duke ruajtur plotësisht kuptimin e fjalisë dhe përmbajtjen e akteve të përkthyer.
3. **“Legjislacioni shqiptar në njërën nga gjuhët e Bashkimit Evropian”** versioni i përkthyer i aktit normativ përkatës të Republikës së Shqipërisë në njërën nga gjuhët e Bashkimit Evropian, i cili është gjuhësisht dhe juridikisht i barabartë me gjuhën shqipe, duke ruajtur plotësisht kuptimin e fjalisë dhe përmbajtjen e aktit të përkthyer.
4. **“Sigurimi i cilësisë”**, një proces rishikimi në dy nivele, duke përfshirë shqyrtimin e terminologjisë specifike sektoriale dhe gjuhësore dhe që synon të sigurojë që përkthimet përmbushin standardet e cilësisë të përcaktuara nga organi kontraktues.

KREU II
RREGULLAT E PËRGJITHSHME PËR PËRZGJEDHJEN E PËRKTHYESIT ZYRTAR

Neni 3
Përzgjedhja e përkthyesit zyrtar nga regjistri elektronik

1. Organet kontraktuese përzgjedhin përkthyes zyrtarë nga regjistri elektronik. Kur përkthyesi zyrtar caktohet nga organi procedues, Gjykata Kushtetuese ose Ministria e Drejtësisë për përkthimet, që kryhen në kuadër të marrëdhënieve juridiksionale me jashtë, zbatohen rregullat e përcaktuara në këtë vendim. Në çdo rast tjetër, procedurat e përzgjedhjes së përkthyesve do të bëhen sipas rregullave të parashikuara në ligjin e prokurimit publik, në bazë të kriterëve që përcakton ky vendim.

2. Përzgjedhja e përkthyesit zyrtar nga regjistri elektronik duhet të garantojë një proces transparent dhe gjithëpërfshirës.

Neni 4

Kriteret për përzgjedhjen e përkthyesit zyrtar

1. Përkthyesi zyrtar përzgjidhet, duke u bazuar në kriteret e mëposhtme:
 - a) arsimimi në fushën për të cilën kërkohet përkthimi;
 - b) vendbanimi i përkthyesit zyrtar ose vendi i ushtrimit të veprimtarisë së përkthimit zyrtar të jetë në apo pranë juridiksionit të organit kontraktues;
 - c) vlerësimet e shërbimit të ofrimit të përkthimit zyrtar, të bëra nga palët kontraktuese të mëparshme;
 - ç) eksperiencat e mëparshme profesionale në fushën për të cilën kërkohet përkthimi;
 - d) studimet e thelluara ose trajnimet e vazhdueshme në fushën për të cilën kërkohet përkthimi;
 - dh) eksperiencat profesionale të mëparshme të përkthyesit zyrtar me palën kontraktuese përzgjedhëse.
2. Në rastet e përkthimit të legjislacionit të Bashkimit Evropian në gjuhën shqipe dhe të legjislacionit shqiptar në njërën nga gjuhët e Bashkimit Evropian, përveç kriterëve të mësipërme, përkthyesi zyrtar përzgjidhet, duke u bazuar edhe në kriteret e mëposhtme:
 - a) të ketë kryer edhe më parë përkthime të *acquis* të Bashkimit Evropian;
 - b) të ketë tituj dhe grada shkencore në gjuhën për të cilën konkurrojnë ose në fusha specifike të *acquis* të Bashkimit Evropian;
 - c) të ketë gjuhë amtare gjuhën e burimit nga e cila kërkojnë të përkthejnë.

KREU III

RREGULLA TË VEÇANTA PËR PËRKTHIMIN E LEGJISLACIONIT TË BASHKIMIT EVROPIAN

Neni 5

Përgatitja e kalendarit vjetor të përkthimit të legjislacionit të Bashkimit Evropian

1. Ministria përgjegjëse për bashkërendimin dhe ndjekjen e ecursë së procesit të përafrimit të legjislacionit vendës me atë të Bashkimit Evropian, në bashkëpunim me negociatorët, ministritë e linjës dhe institucionet e tjera qendrore, përkatësisht sipas fushës së tyre të veprimtarisë, përcakton kalendarin vjetor të *acquis* të Bashkimit Evropian, objekt përkthimi, me qëllim përgatitjen e versionit shqip të *acquis* të Bashkimit Evropian dhe të legjislacionit shqiptar në njërën nga gjuhët e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe ia përcjell atë Ministrisë së Drejtësisë, jo më vonë se data 1 nëntor, për përkthimet që kryhen në vitin pasardhës.

2. Në përgatitjen e kalendarit vjetor, ministria përgjegjëse për bashkërendimin dhe ndjekjen e ecursë së procesit të përafrimit të legjislacionit vendës me atë të Bashkimit Evropian mbështetet në planifikimet trevjeçare të kryera në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian.

3. Ministria përgjegjëse për bashkërendimin dhe ndjekjen e ecursë së procesit të përafrimit të legjislacionit vendës me atë të Bashkimit Evropian kërkon përkthimin e akteve të veçanta normative vendëse në njërën nga gjuhët e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, të paparashikuara në kalendarin vjetor të përkthimit, kur akti i përkthyer kërkohet, në mënyrë

specifike, nga strukturat përkatëse të Bashkimit Evropian për qëllime që lidhen me përmbushjen e angazhimeve të marra në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe negociatave të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Neni 6

Sigurimi i cilësisë së materialeve të përkthyer të legjislacionit të Bashkimit Evropian

1. Materialet e përkthyer nga përkthyesit zyrtarë të legjislacionit të Bashkimit Evropian në gjuhën shqipe i nënshtrohen rishikimit të sigurimit të cilësisë në dy nivele nga komisione të posaçme *ad hoc*, të cilat ngrihen me urdhër të ministrit të Drejtësisë.

2. Këto komisione përbëhen nga:

- a) dy ekspertë të Ministrisë së Drejtësisë;
- b) një ekspert i ministrisë së linjës apo institucionit qendror, fusha e veprimtarisë e të cilit përputhet me fushën e veprimit të legjislacionit të Bashkimit Evropian, që duhet të përkthehet;
- c) dy ekspertë të jashtëm të fushës, të caktuar nga ministri i Drejtësisë, nga të cilët:
 - i. një ekspert për çdo nënkapitull, përgjegjës për zhvillimin e terminologjisë specifike të sektorit dhe rishikimin e përkthimeve;
 - ii. një ekspert gjuhësor, përgjegjës për zhvillimin e terminologjisë dhe kryerjen e rishikimit gjuhësor të përkthimeve.

3. Komisionet e posaçme për sigurimin e cilësisë zhvillojnë terminologjinë specifike sektoriale bazuar në aktet normative që do të përkthehen në vitin aktual përkatës, e cila u vihet në dispozicion përkthyesve zyrtarë që do të kontraktohen për këtë qëllim.

4. Përkthimet zyrtare të legjislacionit të Bashkimit Evropian dorëzohen nga përkthyesit zyrtarë nëpërmjet bazës së të dhënave të krijuar sipas nenit 7 të këtij vendimi dhe miratohen nga Ministria e Drejtësisë vetëm pasi rishikimi i sigurimit të cilësisë të jetë realizuar nga komisionet e posaçme.

5. Rregulla të hollësishme për përzgjedhjen e anëtarëve, si dhe organizimin dhe funksionimin e komisioneve të posaçme për sigurimin e cilësisë së materialeve të përkthyer, sipas kësaj dispozite, përcaktohen me urdhër të ministrit të Drejtësisë.

Neni 7

Për realizimin e veprimtarisë së përkthimit të legjislacionit të Bashkimit Evropian në gjuhën shqipe dhe legjislacionit shqiptar në njërën nga gjuhët e Bashkimit Evropian, Ministria e Drejtësisë:

a) krijon, përditëson dhe administron një bazë të dhënash për përkthimin e legjislacionit të Bashkimit Evropian në gjuhën shqipe dhe anasjelltas, e cila përmban dokumentet e përkthimit, caktimin e detyrave dhe përcaktimin e afatit, procesin e përkthimit dhe procesin e rishikimit të sigurimit të cilësisë. Përkthyesve zyrtarë të përzgjedhur për përkthimin e legjislacionit të Bashkimit Evropian u sigurohet akses në bazën e të dhënave dhe ata kanë të drejtë leximi, shkrimi dhe modifikimi të materialeve që ngarkohen prej tyre. Ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera qendrore janë të detyruara t'i vënë në dispozicion Ministrisë së Drejtësisë *database*-n e legjislacionit të Bashkimit Evropian, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të legjislacionit shqiptar, të përkthyer në njërën nga gjuhët e Bashkimit Evropian;

b) kujdeset për respektimin e unitetit të formës dhe të terminologjisë së përkthimeve të legjislacionit të Bashkimit Evropian në gjuhën shqipe dhe anasjelltas;

c) harton dhe boton dokumente e fjalorë të terminologjisë së specializuar, për përdorimin nga përkthyesit zyrtarë dhe personat e përfshirë në procesin e përkthimit të legjislacionit evropian në gjuhën shqipe dhe anasjelltas;

ç) boton dhe shpërndan kopje të legjislacionit të Bashkimit Evropian, të përkthyer në gjuhën shqipe.

KREU IV RREGULLAT PËR PËRZGJEDHJEN E PËRKTHYESIT ZYRTAR

Neni 8

Komunikimi me përkthyesin zyrtar

1. Organi kontraktues kontakton me telefon ose në rrugë elektronike me përkthyesin zyrtar të përzgjedhur për shërbimin përkatës sipas dispozitave të mësipërme nga regjistri elektronik.
2. Në rast se përkthyesi zyrtar nuk i përgjigjet telefonatës apo postës elektronike, atij i lihet kohë e arsyeshme, por jo më shumë se 4 (katër) orë, për të kthyer përgjigje. Në rast të moskthimit të përgjigjes, organi kontraktues njofton menjëherë përkthyesin zyrtar të radhës që plotëson kriteret për përzgjedhje për gjuhën e kërkuar.
3. Kontaktimi/njoftimi me telefon dokumentohet në një procesverbal të posaçëm nga organi kontraktues, në të cilin tregohen të dhënat e kontaktit dhe mjeti i përdorur për komunikim, data dhe ora e saktë e komunikimit, personi me të cilin kontaktohet dhe qëllimi i komunikimit.
4. Përjashtimisht, kontaktimi/njoftimi në rrugë elektronike dokumentohet përmes printimit të komunikimit ndërmjet organit kontraktues dhe përkthyesit zyrtar, vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:
 - a) komunikimi kryhet përmes adresave zyrtare elektronike;
 - b) në komunikim tregohen qartë informacionet e parashikuara në pikën 3 të këtij neni.
5. Nëse përkthyesi zyrtar, pas marrjes së njoftimit, refuzon marrjen përsipër të detyrës, vijohet me kontaktimin e përkthyesit të radhës që përmbush i dyti kriteret për përzgjedhje për gjuhën e kërkuar.

Neni 9

Refuzimi i kryerjes së përkthimit zyrtar

1. Refuzimi i kryerjes së përkthimit zyrtar bëhet nga përkthyesi zyrtar me shkrim apo në rrugë elektronike, duke bërë me dije shkaqet e refuzimit.
2. Organi kontraktues njofton menjëherë me shkrim ose në rrugë elektronike Ministrinë e Drejtësisë për rastet e refuzimit pa arsye ligjore, si dhe për rastet e moskthimit të përgjigjes brenda afatit të kërkuar.
3. Në rastet kur Ministria e Drejtësisë vlerëson se refuzimi i përkthyesit zyrtar nuk është bërë për arsyet e përcaktuara në nenin 25 të ligjit për përkthimin zyrtar, fillon procedurën e hetimit disiplinor, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji.

Neni 10

Lidhja e kontratës për përkthim zyrtar

1. Me marrjen përsipër të shërbimit të përkthimit zyrtar, përkthyesi zyrtar lidh kontratën për përkthimin zyrtar.
2. Format i kontratës për përkthimin zyrtar bëhet sipas shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 11

Shpërblimi i përkthyesit zyrtar

Për kryerjen e shërbimit të përkthimit zyrtar, përkthyesi zyrtar shpërblehet sipas përcaktimeve në udhëzimin e përbashkët të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë për caktimin e tarifave për kryerjen e shërbimit të përkthimit zyrtar.

KREU V RREGULLAT PËR VLERËSIMIN DHE KONTROLLIN E PËRKTHYESIT ZYRTAR

Neni 12

Vlerësimi i shërbimit të përkthyesit zyrtar

1. Pas kryerjes së përkthimit zyrtar, organi kontraktues bën vlerësimin e shërbimit të dhënë nga përkthyesi zyrtar, sipas formularit të vlerësimit, i cili mund të aksesohet nga regjistri elektronik dhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.

2. Formulari i vlerësimit të shërbimit të përkthyesit zyrtar i dërgohet Ministrisë së Drejtësisë brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e përfundimit të përkthimit zyrtar.

Neni 13

Kontrolli i shërbimit të përkthyesit zyrtar

1. Nëpunësit e strukturës përgjegjëse për përkthimin zyrtar në Ministrinë e Drejtësisë kontrollojnë shërbimin e dhënë nga përkthyesi zyrtar, duke vlerësuar elementet e mëposhtme:

a) respektimin e detyrimeve të përkthyesit zyrtar, sipas ligjit për përkthimin zyrtar, Kodit të Etikës së Përkthyesit Zyrtar dhe akteve të tjera;

b) respektimin e detyrimeve kontraktore për ofrimin e përkthimit zyrtar;

c) kohën në të cilën realizohet përkthimi zyrtar;

ç) cilësinë e përkthimit zyrtar brenda afatit të kërkuar;

d) komunikimin etik dhe profesional me kontraktuesin.

2. Për zbatimin e kësaj dispozite, Ministria e Drejtësisë mund të kërkojë nga përkthyesi zyrtar apo organi kontraktues të dhëna dhe informacione të tjera për përkthimin zyrtar.

3. Në rast se Ministria e Drejtësisë konstaton dhe evidenton mangësi në veprimtarinë e përkthyesit zyrtar, urdhëron marrjen e masave për korrigjimin e mangësive përkatëse, duke caktuar një afat për korrigjimin e tyre.

4. Në rast se ekziston një dyshim i arsyeshëm se një mangësi e tillë mund të përbëjë shkelje disiplinore, ministri i Drejtësisë fillon procedurën për hetimin disiplinor, në përputhje me përcaktimet e ligjit për përkthimin zyrtar.

KREU VI DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 14

Shfuqizime

Vendimi nr. 119, datë 7.3.2007, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave të përkthimit të legjisllacionit të Bashkimit Evropian në gjuhën shqipe dhe të përkthimit të legjisllacionit shqiptar në njërën nga gjuhët e Bashkimit Evropian”, dhe aktet e tjera nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij, shfuqizohen.

Neni 15

Organet zbatuese

Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, autoritetet publike përkatëse dhe përkthyesit zyrtarë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Neni 16

Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

SHTOJCA NR. 1 (Formati i kontratës për përkthim zyrtar)

KONTRATË PËR PËRKTHIM ZYRTAR

Kjo kontratë për përkthim zyrtar ("kontrata") lidhet sot në datën __. __. __, në _____, nga dhe nëpërmjet palëve, si më poshtë:

A. Organit kontraktues _____, me adresë _____, përfaqësuar nga z./znj. _____, identifikuar me ID/pasaportë, me numër personal _____, me adresë _____, adresë elektronike _____ (këtu me poshtë referuar si "porositësi") dhe

B. Përkthyesit zyrtar _____, shtetas _____, lindur më _____, banues në _____, identifikuar me ID/pasaportë, me numër personal _____, me certifikatë nr. _____, datë _____, me NUIS nr. _____/i punësuar pranë subjektit _____, me adresë _____, adresë elektronike _____, nr. tel./fax./mob. _____ (këtu me poshtë referuar si "i porosituari").

Palët në këtë kontratë do të referohen veçmas si "Pala" ose së bashku si "Palët".

Baza ligjore: Lidhja dhe zbatimi i kësaj kontrate shërbimi bazohet në nenin 659 e vijues të Kodit Civil dhe ligjin nr. 82/2021, "Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar". Për përcaktimin e tarifave zbatohet udhëzimi i përbashkët i ministrit të Drejtësisë dhe ministrit përgjegjës për financat për caktimin e tarifave për kryerjen e shërbimit të përkthimit zyrtar në fuqi.

Palët e mësipërme bien dakord të lidhin midis tyre kontratën, si më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti i kontratës

Objekti i kësaj kontrate është ofrimi i shërbimit të përkthimit zyrtar të dokumenteve zyrtare nga i porosituari, në favor të porositësit, në varësi të kërkesës dhe nevojës së porositësit, sipas kushteve të përcaktuara në këtë kontratë dhe përcaktimeve të ligjit nr. 82/2021, "Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar" ("ligji për përkthimin zyrtar").

Neni 2

Përkufizime

1. "Dokument zyrtar" është çdo dokument që porositësi i jep të porositurit për përkthim zyrtar, në kuptim të ligjit për përkthimin zyrtar.

2. "Llogaritja e vëllimit të përkthimit dhe çmimeve të përkthimit" është llogaritja që bëhet në bazë të kritereve të përcaktuara në udhëzimin e përbashkët të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit përgjegjës për financat për caktimin e tarifave për kryerjen e shërbimit të përkthimit zyrtar.

3. “Gjuhë” është gjuha e burimit dhe gjuha e synuar, sipas përkufizimit të ligjit për përkthimin zyrtar.

Neni 3

Parimet e ofrimit të shërbimit të përkthimit zyrtar

1. Shërbimi i përkthimit zyrtar nga i porosituri bazohet veçanërisht mbi parimet e mëposhtme:
 - a) profesionalizmi;
 - b) ruajtja e etikës dhe integritetit;
 - c) besnikëria ndaj tekstit burimor;
 - ç) paanshmëria;
 - d) konfidencialiteti i të dhënave;
 - dh) mosdiskriminimi dhe trajtimi i barabartë.
2. Përveç sa më sipër, kryerja e shërbimit të përkthimit zyrtar nga i porosituri bazohet mbi parimet e Kodit të Etikës së Përkthyesit Zyrtar.
3. Shkelja e parimeve të përcaktuara në këtë nen përbën shkelje të rëndë të kësaj kontrate dhe passjell aplikimin e sanksioneve dhe masave disiplinore, sipas parashikimeve të ligjit për përkthimin zyrtar dhe çdo ligji tjetër të aplikueshëm.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e porositësit

- Porositësi ka të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme:
- a) të japë një kopje nga dokumenti zyrtar origjinal, duke përcaktuar numrin e faqeve, gjuhën e burimit dhe gjuhën apo gjuhët e synuara, si dhe afatin brenda të cilit do të dorëzohet. Numri i saktë i faqeve të përkthimit zyrtar dhe dorëzimi i tij bëhet në përputhje me procesverbalin, formati i të cilit përcaktohet në shtojcën nr. 1, që i bashkëlidhet kësaj kontrate dhe është pjesë e pandarë e saj;
 - b) të paralajmërojë të porositurin për nivelin e klasifikimit “sekret shtetëror” të dokumentit zyrtar dhe trajtimin e dokumentit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror;
 - c) të pranojë përkthimin e dokumentit zyrtar të dhënë prej tij në formë elektronike dhe dy kopje të printuara, të nënshkuara dhe të vulosura në çdo faqe nga i porosituri, së bashku me deklaratën e nënshkuar se e ka përkthyer atë me saktësi, me kujdesin e duhur dhe me përgjegjësi ligjore;
 - ç) të paguajë në kohë detyrimin financiar për përkthimin zyrtar të kryer pas marrjes në dorëzim të përkthimit, përveç rastit të parashikuar në shkronjën “d” të këtij neni;
 - d) kur ka rezervë për cilësinë e përkthimit, porositësi njofton të porositurin brenda 15 ditëve nga marrja e përkthimit, me qëllim ridorëzimin e dokumentit zyrtar në gjuhën e synuar në cilësinë e kërkuar. Me kalimin e këtij afati dhe në çdo rast tjetër të shkaktimit të dëmit për shkak të përkthimit të paqartë, të pasaktë ose të gabuar, i porosituri detyrohet të dëmshpërblejë sipas ligjit;
 - dh) porositësi, në rast se i porosituri nuk dorëzon dokumentin zyrtar në gjuhën e synuar në kohën, cilësinë dhe formatin e kërkuar, duke sjellë si pasojë mosrespektimin e afateve, pasaktësi, parregullsi dhe deformim të përmbajtjes së dokumentit zyrtar apo dështon në përmbushjen e detyrimeve që ka ndaj porositësit, ka të drejtë të përfundojë në mënyrë të njëanshme kontratën;
 - e) në çdo rast të konstatimit apo vërtetimit të mospërmbushjes së detyrimeve që burojnë nga ligji për përkthimin zyrtar dhe nga kjo kontratë nga i porosituri, duhet të njoftojë menjëherë me shkrim Ministrinë e Drejtësisë.

Neni 5

Të drejtat dhe detyrimet e të porositurit

I porositori ka të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme:

a) të realizojë përkthimin, sipas përcaktimeve, kushteve dhe afateve të kontratës dhe procesverbalit tip bashkëlidhur kësaj kontrate, duke dorëzuar përkthimin zyrtar në formë elektronike dhe në dy kopje të printuara në formatin *Times New Roman*, madhësia e shkrimit 12, hapësira midis rreshtave 1 (përveç rasteve kur ky format nuk mund të aplikohet p.sh. në tabela, grafikë e skema), të nënshkruara dhe të vulosura në çdo faqe nga i porositori, së bashku me deklaratën e nënshkruar se e ka përkthyer atë me saktësi, me kujdesin e duhur dhe me përgjegjësi ligjore;

b) t'i përgjigjet kërkesës për t'u paraqitur pranë porositesit, sa herë që kërkohet, të marrë në dorëzim dokumentin zyrtar për përkthim, si dhe të tregojë disponibilitet për përmbushjen e këtij detyrimi në kohë;

c) të kryejë përkthimin personalisht dhe në asnjë rast nëpërmjet të tretëve. Nëse vërtetohet se i porositori ia ka kaluar dokumentin zyrtar për përkthim zyrtar një pale të tretë, kontrata zgjidhet menjëherë nga porositesi, si dhe fillohet procedimi disiplinor për përkthyesin zyrtar, sipas ligjit për përkthimin zyrtar;

ç) të respektojë karakterin "sekret shtetëror" të dokumentit zyrtar, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi. Mosrespektimi i këtyre kërkesave e ngarkon personalisht përkthyesin zyrtar me përgjegjësi të drejtpërdrejtë sipas ligjit;

d) të kryejë përkthimin me bazë materiale të vetën;

dh) të bëjë vullnetarisht korrigjime të pasaktësive apo të gabimeve në përkthimin e kryer të dokumentit zyrtar, përveçse kur kundërshton me shkrim brenda 48 orëve nga njoftimi i pretendimit të porositesit;

e) për çdo ditë vonesë në dorëzimin e përkthimit detyrohet të paguajë 1000 (një mijë) lekë gjorbë në ditë ndaj porositesit;

ë) të respektojë kërkesat e legjislacionit në fuqi për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to, lidhur me përkthimet zyrtare në fushën e legjislacionit dhe vendimet gjyqësore;

f) të njoftojë menjëherë porositesin për çdo ndryshim të të dhënave të tij;

g) çdo të drejtë dhe detyrim tjetër, sipas përcaktimeve të ligjit për përkthimin zyrtar.

Neni 6

Tarifa e shërbimit dhe mënyra e pagesës

1. Tarifa e shërbimit të përkthimit zyrtar nga i porositori përcaktohet në bazë të kriterëve të parashikuara në udhëzimin e përbashkët të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit përgjegjës për financat për caktimin e tarifave për kryerjen e shërbimit të përkthimit zyrtar. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, i porositori pranon çmimin e përcaktuar në udhëzimin e përbashkët të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit përgjegjës për financat për caktimin e tarifave për kryerjen e shërbimit të përkthimit zyrtar.

2. Porositesi paguan tarifën e shërbimit në llogarinë bankare të të porositorit me të dhënat, si më poshtë vijon:

- a) përfituesi;
- b) banka;
- c) SWIFT;
- ç) IBAN.

Neni 7

Zgjidhja e njëanshme e kontratës

1. Në rast të mospërmbushjes së detyrimeve nga porositesi/i porositori, sipas përcaktimeve të kësaj kontrate dhe ligjit për përkthimin zyrtar, porositesi/i porositori ka të drejtë të zgjidhë në

mënyrë të njëanshme kontratën, me përjashtim të rasteve kur arsyet e dhëna nga pala për mospërbushje detyrimi përbëjnë forcë madhore ose janë të justifikuara dhe të vërtetuara me dokumente mbështetëse përkatëse.

2. Zgjidhja e njëanshme e kontratës bëhet me shkrim. Pala, që kërkon zgjidhjen e kontratës, sipas pikës 1 të këtij neni, njofton me shkrim palën tjetër të paktën 5 ditë përpara datës së kërkuar për zgjidhjen e kontratës, duke i bërë me dije arsyet e zgjidhjes së kontratës.

Neni 8

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Çdo mosmarrëveshje, pretendim apo kundërshti që lind nga ose në lidhje me këtë kontratë, duke përfshirë por pa u kufizuar, interpretimin, zbatimin dhe çdo element tjetër lidhur me vlefshmërinë ose përfundimin e kësaj kontrate, zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet palëve.

2. I porosituri detyrohet të vazhdojë përbushjen e detyrimeve ndaj porositësit, gjatë shqyrtimit të mosmarrëveshjeve, sipas pikës 1 të këtij neni, kur një gjë e tillë kërkohet nga porositësi.

3. Nëse nuk arrihet zgjidhja me mirëkuptim dhe marrëveshje mes palëve, ato mund t'i drejtohen gjykatës kompetente.

Neni 9

Shtesat dhe ndryshimet në kontratë

Të gjitha shtesat dhe ndryshimet në këtë kontratë nuk do të kenë vlerë ligjore nëse nuk janë miratuar dhe nënshkruar rregullisht nga palët.

Neni 10

Interpretimi i kontratës

Kjo kontratë do të rregullohet dhe do të interpretohet, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm të Republikës së Shqipërisë.

Neni 11

Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja

1. Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga të dyja palët dhe është e vlefshme për një afat _____ nga data e hyrjes në fuqi.

2. Afati i kësaj kontrate mund të rinovohet me marrëveshje me shkrim mes palëve ose në mënyrë të heshtur, nëse asnjëra nga palët nuk i komunikon me shkrim palës tjetër ndërprerjen e kontratës.

Neni 12

Parashikime të fundit

1. Kjo kontratë u hartua në 3 (tri) kopje me vlerë të njëjtë ligjore, nga të cilat 2 (dy) mbahen nga porositësi dhe 1 (një) nga i porosituri.

2. Kontrata nënshkruhet në çdo fletë nga palët.

Kjo kontratë, pasi u lexua me zë të lartë dhe kuptua, u nënshkrua rregullisht, nga palët si më poshtë:

PALËT

PËR POROSITËSIN

I POROSITURI

SHTOJCA NR. 1

Procesverbal për dorëzimin e përkthimit zyrtar

Sot, më datë _____, në _____ (emri i porositësit), me adresë _____, mbahet ky procesverbal ndërmjet _____ (emri i porositësit), përfaqësuar nga z./znj. _____ dhe përkthyesit zyrtar z./znj. _____, për sa më poshtë:
Në mbështetje të ligjit nr. 82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”, dhe kontratës me nr. _____, datë _____, i jepet për përkthim zyrtar nga gjuha e burimit _____ në gjuhën e synuar _____ brenda afatit _____, kopja konform origjinalit të dokumentacionit me nr. prot _____, datë _____ mbi _____ me _____ faqe fizike, përkthyesit zyrtar z./znj. _____.

PËR POROSITËSIN

I POROSITURI

Përkthimi zyrtar u dorëzua në datën _____ dhe përmban _____ karaktere të barabarta me _____ faqe kompjuterike.

MORI NË DORËZIM:

PËR POROSITËSIN

I POROSITURI
